



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

RAPORT

**PËR VETEVALUIMIN E BRENDSHËM TË FAKULTETIT TË
BUJQËSISË DHE BIOTEKNOLOGJISË PËR VITET AKADEMIKE
2019/2020; 2020/2021; 2021/2022**

Tetovë, 2024

**Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë-Факултет за земјоделство и биотехнологија-
Faculty of Agriculture and Biotechnology**
Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk – e-mail: ba@unite.edu.mk

PËRMBAJTJA

1. QËLLIMI I PROCESIT TË VETEVALUIMIT.....	3
2. PËRSHKRIMI FAKULTETIT	3
2.1. Zhvillimi historik	3
2.2. Misioni	4
2.3. Imperativi i Fakultetit.....	4
3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FBB-së.....	4
3.1 Organogrami	4
3.2. Programet studimore	5
3.3. Vlerësimi i plan-programit në nivel të programeve studimore (Agrobiznes, Prodhimtari Bimore, Prodhimtari Animale)	6
3.4. Vlerësimi i programeve studimore.....	7
4. VEPRIMTARIA MËSIMORE NË FBB.....	8
5. STRUKTURA E KUADRIT MËSIMOR-SHKENCOR TË FBB-SË.....	9
6. STRUKTURA E STUDENTËVE NË STUDIMET DERIDIPLOMIKE.....	15
7. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE	19
8. HAPËSIRAT DHE PAJISJET	20
9. SWOT ANALIZA	21
10. KONKLUDIMI.....	23

1. QËLLIMI I PROCESIT TË VETEVALUIMIT

Evaluumi i brendshëm i Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë për vitet akademike 2019/2020; 2020/2021 dhe 2021/2022 është realizuar në muajt tetor-nëntor të vitit 2023. Qëllimi i vetevaluimit ishte identifikimi i gjendjes momentale të Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë dhe përfundimet nga i njëjti të shërbejnë si bazë e mbindërtimit të kualitetit të procesit mësimor-shkencor në studimet deridiplomike. Evaluimi i brendshëm u realizua nga Komisioni për vetevaluim i Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë. Në procesin e evaluimit është përfshirë:

- Përshkrimi i Fakultetit
- Struktura organizative e Fakultetit
- Veprimtaria mësimore
- Struktura e kuadrit mësimor-shkencor
- Struktura e studentëve
- Anketimi i studentëve
- Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte
- Hapësirat dhe resurset materiale
- SWOT analiza
- Përfundimi

Gjatë realizimit të procesit të evaluimit në vazhdimësi kanë ndihmuar profesorët, bashkëpunëtorët, administrata dhe studentët të cilët kanë qenë të kyçur në forma të ndryshme me qëllim që ky proces të realizohej me sukses.

2. PËRSHKRIMI FAKULTETIT

2.1. Zhvillimi historik

Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë është institucion i lartë arsimor në kuadër të Universitetit të Tetovës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjeneza e të cilit nisi në vitin 2015. Fillimisht, Fakultetit i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë kishte tre programe studimore: Agrobiznes, Prodhimtari Bimore dhe Bioteknologji Animale. Gjashtë vjet më vonë, konkretisht në vitin 2021 janë riakredituar programet studimore Agrobiznes dhe

Prodhimtari Bimore ndërsa programi studimor Bioteknologji Animale është akredituar si program studimor Prodhimtari Animale.

2.2. Misioni

Prioritet global i bujqësisë është përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe mbrojtjes së mjedisit, në përputhje me këto procese.

Fakulteti ka për qëllim:

- Ndjekjen e metodave më të reja të prodhimitarisë bujqësore intensive, përdorimin sa më adekuat të mekanizimit bujqësor, produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe të ngjashme;
- Krijimin e kuadrove shkencore të një modeli të një arsimimi evropian, të aftë për kyçje në punët hulumtuese-shkencore në lëmin e bujqësisë, bioteknologjisë dhe mjedisit jetësor;
- Transferin e teknologjive të reja në bujqësi përmes bashkëpunimit intensiv me fermerët, kapacitetet përpunuese dhe institucionet e ngjashme në vend, në rajon dhe në botë.

2.3. Imperativi i Fakultetit

Imperativi i Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë është të krijojë një profil profesional dhe akademik, i cili do të zotërojë njohuritë e nevojshme për t'u përballur me sfidat e ndryshme që i ka bujqësia në drejtim të prodhimitarisë, menaxhimit, mbrojtjes, dhe përpunimit të produkteve bujqësore si dhe të kërkesave të tregut.

3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FBB-së

3.1. Organogrami

Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë veprimtarinë e vet e bazon në Ligjin për arsim të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, prandaj në kuadër të Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë ekzistojnë organet përkatëse të parapara me Ligjin për arsim të lartë siç janë:

- Këshilli mësimor-shkencor i cili përbëhet nga profesorë të zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore dhe përfaqësuesit e studentëve
- Dekani
- Prodekanët
- Sekretari
- Shefat e programeve studimore
- Administrata
- Shërbimi teknik

Këshillin mësimor-shkencor të Fakultetit të Buqësisë dhe Bioteknologjisë e udhëheq dekan, ndërsa të gjitha vendimet në Fakultet i merr Këshilli mësimor-shkencor me shumicë votash, duke përfshirë këtu edhe zgjedhjen me votim të fshehtë të dekanit dhe prodekanëve, komisionit të evaluimit etj. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Këshillin mësimor-shkencor të cilët zgjidhen nga Parlamenti Studentor.

Organogrami i Fakultetit të Buqësisë dhe Bioteknologjisë

Këshilli mësimor - shkencor	
Dekani	
Prodekani për arsim	Prodekani për shkencë
Sekretari	
Mësimdhënësit	Studentët
Administrata	Shërbimi teknik

3.2. Programet studimore

Në kuadër të Fakultetit të Buqësisë dhe Bioteknologjisë janë të akredituara studimet deridiplomike. Struktura e programeve studimore të Fakultetit të Buqësisë dhe Bioteknologjisë me drejtimet përkatëse të tyre në ciklin e parë të studimeve është paraqitur në tabelën 1.

Tabela 1. Programet studimore të Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë – cikli i parë

	Programi studimor	Nr. i sem.	ECTS	Titulli
1	Agrobiznes	8	240	Inxhiner i diplomuar i Bujqësisë - Agroekonomist
2	Prodhimtari Bimore	8	240	Inxhiner i diplomuar i Bujqësisë - Prodhimtari Bimore
3	Prodhimtari Animale	8	240	Inxhiner i diplomuar i Bujqësisë - Prodhimtari Animale

3.3. Vlerësimi i plan-programit në nivel të programeve studimore (Agrobiznes, Prodhimtari Bimore, Prodhimtari Animale)

Bashkëpunimi me kompanitë / institucionet në nivel të programeve studimore

Programi studimor **Agrobiznes** realizon bashkëpunim me kompani të ndryshme si: “Vezë Sharri”, “Agrovali-Ti”, “Eurofrit”, “Vitamil”, “Rossen Centar”, “Negotino farm” me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, prej të cilave gjashtë institucione janë private, një publike. Puna praktike e studentëve e paraparë me plan-programin studimor realizohet plotësisht në tre prej këtyre kompanive, kurse në dy prej tyre realizohet pjesërisht. Prej këtyre kompanive tre prej tyre paraqesin pjesërisht mundësi punësimi për studentët.

Programi studimor **Prodhimtari Bimore** realizon bashkëpunim me kompani të ndryshme, si: “Vezë Sharri”, “Agrovali-Ti”, “Eurofrit”, “Vitamil”, “Rossen Centar”, “Negotino farm”, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, shkollën e mesme profesionale “Mosha Piade” etj., nga të cilat gjashtë institucione janë private, dy publike.

Puna praktike e studentëve e paraparë me plan-programin studimor realizohet plotësisht në tre prej këtyre kompanive, kurse në dy prej tyre realizohet pjesërisht. Prej këtyre kompanive tre prej tyre paraqesin pjesërisht mundësi punësimi për studentët.

Bashkëpunimi me këto kompani/institucione është pjesërisht i rëndësishëm për këtë program studimor. Prej tyre vetëm dy shkolla paraqesin pjesërisht mundësi punësimi për studentët.

Programi studimor **Prodhimtari Animale** realizon bashkëpunim me kompani të ndryshme, si: “Vezë Sharri”, “Rossen Centar”, “Negotino farm”, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe

Ekonomisë së Ujërave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, shkolla e mesme profesionale “Mosha Piade” etj.

Bashkëpunimi i tillë përgjithësisht është shumë i rëndësishëm për këtë program studimor. Në të gjitha institucionet, studentët relativisht realizojnë punën praktike të paraparë në plan-program si dhe tre prej tyre paraqesin mundësi punësimi për studentët.

3.4. Vlerësimi i programeve studimore

Programi studimor Agrobiznes

- Në kuadër të programit studimor, të gjitha lëndët obligative janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit. Në plan-programin e akredituar në vitin 2015 nga gjithsej 78 lëndë prej të cilave 52% janë lëndë obligative, 40% të lëndëve janë zgjedhore dhe 8% lëndë opsionale. Ndërsa në plan-programin e riakredituar në vitin 2021 nga gjithsej 64 lëndë prej të cilave 50% janë lëndë obligative, 50% të lëndëve janë zgjedhore.
- Lëndët e programit studimor Agrobiznes janë të orientuara plotësisht në zhvillim të kompetencave të parapra me deskriptorët e programit.
- Vendosja kronologjike e lëndëve të programit studimor Agrobiznes relativisht është në kontinuitet të zhvillimit dhe mbindërtimit të njohurive dhe shkathtësive të studentëve.
- Në kuadër të aktiviteteve të planifikuara me të cilat ngarkohen studentët me qëllim të përfitimit të kompetencave përkatëse, të gjitha lëndët obligative dhe zgjedhore janë të planifikuara në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas numrit të kredive të lëndës përkatëse. Lëndët obligative kanë nga 6 ECTS kurse lëndët zgjedhore nga 3 ECTS.
- Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit në fushën shkencore si dhe përmbajtjen dhe literaturën e ofruar, lëndët obligative dhe zgjedhore kanë pjesërisht nevojë që gjatë akreditimit të ardhshëm të azhurnohen me qëllim të plotësimi të kërkesave bashkëkohore në lidhje me arritjet në fushën e agrobiznesit.

Programi studimor Prodhimtari Bimore

- Në kuadër të programit studimor Prodhimtari Bimore, 83% të lëndëve janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit kurse pjesa tjetër ka përputhshmëri të pjesërishtme.
- Në plan-programin e akredituar në vitin 2015 nga gjithsej 78 lëndë, 52% janë lëndë obligative, 40% e lëndëve janë zgjedhore dhe 8% lëndë opsionale. Ndërsa në plan-programin e riakredituar në vitin 2021 nga gjithsej 64 lëndë, 50% janë lëndë obligative, 50% e lëndëve janë zgjedhore.
- Vendosja kronologjike e lëndëve të programit studimor Prodhimtari Bimore, në kontinuitet zhvillojnë dhe mbindërtojnë njohuritë dhe shkathtësitë e studentëve.
- Aktivitetet e planifikuara me të cilat ngarkohen studentët me qëllim të përfitimit të kompetencave përkatëse, në 96% të lëndëve janë të planifikuara në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas numrit të kredive të lëndës përkatëse. Lëndët obligative kanë nga 6 ECTS kurse lëndët zgjedhore nga 3 ECTS.
- Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit shkencore si dhe përmbajtjen dhe literaturën e ofruar, rreth 85% e lëndëve obligative dhe zgjedhore kanë nevojë që gjatë akreditimit të ardhshëm të azhurnohen me qëllim të plotësimit të kërkesave bashkëkohore në lidhje me arritjet në fushën e prodhimitarisë bimore.
- Prej lëndëve të cilat përbëjnë programin studimor Prodhimtari Bimore, rreth 68% e lëndëve obligative dhe zgjedhore pjesërisht nxisin zhvillimin e shkathtësive të cilat janë të aplikueshme në treg të punës.

4. VEPRIMTARIA MËSIMORE NË FBB

Programet studimore të Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë janë dizajnuar sipas kriterëve të Sistemit të Bolonjës që mundëson realizimin e veprimtarisë sipas standardeve evropiane bashkëkohore. Me akreditimin e vitit 2015/16 programet studimore të FBB-së studentëve u ofrojnë studime katërvjeçare të ciklit të parë në të cilat gjithsej grumbullojnë 240 (ECTS) kredi. Numri i kredive për një lëndë mësimore sillet prej 2 (dy) deri në 6 (gjashtë) kredi, kurse punimi i diplomës ka 6 (gjashtë) kredi. Gjithashtu, në të gjitha drejtimet, në afatet e parapara të semestrave përkatës, realizohen kolokuiumet për çdo lëndë, ku në kuadër të një semestri realizohen dy kolokuiume.

Është me rëndësi të theksohet se në FBB numri i lëndëve obligative, lëndëve zgjedhore dhe lëndëve zgjedhore opsionale është në raport përqindor 70:30:10. Pra, studentët përveç lëndëve obligative që janë të përfaqësuara me 70%, kanë mundësi që 30% të lëndëve t'i zgjedhin vetë nga lista e lëndëve zgjedhore dhe 10% të lëndëve i zgjedhin nga lista e lëndëve zgjedhore opsionale në nivel të Universitetit.

Procesi mësimor në Fakultetin e Buqësisë dhe Bioteknologjisë realizohet me mësim teorik, mësim praktik, mësim laboratorik dhe mësim terreni. Realizimi i ligjëratave dhe ushtrimeve në kuadër të Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë rrjedh sipas dinamikës së paraparë në programin e fakultetit. Mësimi teorik dhe mësimi laboratorik realizohen në objektet e Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë, ndërsa mësimi praktik, për shkak të karakteristikave lëndore realizohet në hapësirat e objekteve përkatëse. Më konkretisht, praktika profesionale realizohet në institucione përkatëse, respektivisht në barnatore bujqësore, sera bujqësore, kompani prodhuese bujqësore etj.

Realizimi i mësimit në terren i programit studimor Prodhimtari Bimore është realizuar në pjesën lindore të Maqedonisë së Veriut konkretisht në qytetet, Valandovë, Strumicë dhe Veles ku studentët më së afërmi janë njoftuar me organizimin e prodhimit për disa kultura perimore, pemtare dhe lavërtare.

5. STRUKTURA E KUADRIT MËSIMOR-SHKENCOR TË FBB-SË

Viti akademik 2019/2020

Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Bioteknologjisë procesi mësimor realizohet nga gjithsej 10 mësimdhënës prej të cilëve 6 janë profesorë, ndërsa 4 janë bashkëpunëtorë (tabela 2 dhe 3). Numri i profesorëve të punësuar me marrëdhënie pune të rregullt në FBB gjithsej është 5, prej të cilëve 2 janë ordinarë dhe 3 docentë. Për realizimin e lëndëve profesionale është i angazhuar 1 profesor ordinar part-time. Nga kuadri i bashkëpunëtorëve, 3 janë të punësuar me marrëdhënie pune të rregullt, ndërsa 1 është i angazhuar part-time.

Nëse shikohet tabela 3 dhe 4 duke u fokusuar në proporcionin gjinor të stafit akademik vërehet se dominon gjinia mashkullore ndaj asaj femërore (prej stafit akademik të brendshëm 20% janë të gjinisë femërore).

Duhet theksuar se procesi i zgjedhjes dhe rizgjedhjes së kuadrit në Fakultetin të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë realizohet në përputhshmëri me kriteret e Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Statutit të Universitetit të Tetovës dhe Rregullores për zgjedhje dhe rizgjedhje.

Tabela 2. Mësimdhënësit e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Bioteknologjisë gjatë vitit akademik 2019/2020

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE BIOTEKNOLOGJISË							
I rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Ordinar	2	/	2	Ordinar	1	/	1
Inordinar	/	/	/	Inordinar	/	/	/
Docent	3	/	3	Docent	/	/	/
Gjithsej	5	/	5	Gjithsej	1	/	/

Tabela 3. Asistentët e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Bioteknologjisë gjatë vitit akademik 2019/2020

FAKULTETI I BUQËSISË DHE BIOTEKNOLOGJISË							
I rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Asistentë	1	2	3	Asistentë	1	/	1

Mosha dhe gjinia e stafit akademik

Mosha mesatare e stafit është 48,6 vjet. Stafii mësimdhënës përbëhet nga një moshë mesatarisht e re, ku vlen të theksohet që grup-mosha 30-34 vjeç përbën 10%, prej të cilëve 20% janë femra. Grup-moshat e tjera janë paraqitur qartë në tabelën 4.

Tabela 4. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët në FBB sipas gjinisë dhe moshës gjatë vitit akademik 2019/2020

	Mosha	Gjinia			Mësimdhënës (docent, inordinar, ordinar)			Bashkëpunëtorë		
		M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej
1	Deri 25	/	/	/	/	/	/	/	/	/
2	25-29	/	/	/	/	/	/	/	/	/

3	30-34	1	1	2	/	/	/	1	1	2
4	35-39	/	1	1	/	/	/	/	1	1
5	40-44	1	/	1	1	/	1			/
6	45-49	/	/	/	/	/	/	/	/	/
7	50-54	2	/	2	2	/	2	/	/	/
8	55-59	1	/	1	1	/	1	/	/	/
9	60-64	3	/	3	2	/	2	1		1
10	65 e më shumë	/	/	/	/	/	/	/	/	/
11	Gjithsej	8	2	10	6	0	6	2	2	4

Viti akademik 2020/2021

Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Bioteknologjisë procesi mësimor realizohet nga gjithsej 12 mësimdhënës, prej të cilëve 8 janë profesorë, ndërsa 4 janë bashkëpunëtorë (tabela 6 dhe 7). Numri i profesorëve të punësuar me marrëdhënie pune të rregullt në FBB gjithsej është 10, prej të cilëve 2 janë ordinarë dhe 5 docentë. Numri i profesorëve part-time gjithsej është 1 profesor ordinar. Nga kuadri i bashkëpunëtorëve, 3 janë të punësuar me marrëdhënie pune të rregullt, ndërsa 1 është i angazhuar part-time.

Nëse shikoni tabelën 5 dhe 6 duke u fokusuar në proporcionin gjinor të stafit akademik vërejmë se dominon gjinia mashkullore ndaj asaj femërore. Prej bashkëpunëtorëve të brendshëm, 50% janë të gjinisë femërore dhe 50 % të gjinisë mashkullore.

Duhet theksuar se procesi i zgjedhjes dhe rizgjedhjes së kuadrit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë realizohet në përputhshmëri me kriteret e Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Statutit të Universitetit të Tetovës dhe Rregullores për zgjedhje-rizgjedhje.

Tabela 5. Mësimdhënësit e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Bioteknologjisë gjatë vitit akademik **2020/2021**

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE BIOTEKNOLOGJISË							
I rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Ordinar	2	0	2	Ordinar	1	0	1
Inordinar	0	0	0	Inordinar	0	0	0
Docent	5	0	5	Docent	0	0	0
Gjithsej	7	0	7	Gjithsej	1	0	1

Tabela 6. Mësimdhënësit e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Bioteknologjisë gjatë vitit akademik **2020/2021**

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE BIOTEKNOLOGJISË							
I rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Asistentë	1	2	3	Asistentë	1	0	1

Mosha dhe gjinia e stafit akademik

Mosha mesatare e stafit është 50,1 vjet. Stafi mësimdhënës përbëhet nga një moshë e mesme, ku vlen të theksohet që grup-mosha 60-64% është e përfaqësuar me 35%. Grup-moshat tjera janë paraqitur qartë në tabelën 7.

Tabela 7. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët në FBB sipas gjinisë dhe moshës gjatë vitit akademik 2020/2021

Moshë	Gjinia	Mësimdhënës (docent, inordinar,ordinar)			Bashkëpunëtorë					
		M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej			
1	Deri 25	/	/	/	/	/	/	/	/	
2	25-29	/	/	/	/	/	/	/	/	
3	30-34	/	1	1	/	/	/	1	1	
4	35-39	1	1	2	/	/	/	1	1	2
5	40-44	1	/	1	1	/	1	/	/	/
6	45-49	/	/	/	/	/	/	/	/	/

7	50-54	1	/	1	1	/	1	/	/	/
8	55-59	2	/	2	2	/	2	/	/	/
9	60-64	3	/	3	2	/	2	1	/	1
10	65 e më shumë	/	/	/	/	/	/	/	/	/
11	Gjithsej	8	2	10	6	0	6	2	2	4

Viti akademik 2021/2022

Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Bioteknologjisë procesi mësimor realizohet nga gjithsej 12 mësimdhënës, prej të cilëve 11 janë profesorë, ndërsa 1 është bashkëpunëtor (tabela 8 dhe 9). Numri i profesorëve të punësuar me marrëdhënie pune të rregullt në FBB gjithsej është 11, prej të cilëve 2 janë ordinarë, 2 inordinarë dhe 6 docentë. Numri i profesorëve part-time gjithsej është 1. Nga kuadri i bashkëpunëtorëve vetëm 1 është i angazhuar part-time.

Nëse shikoni tabelën 8 dhe 9 duke u fokusuar në proporcionin gjinor të stafit akademik vërejmë se edhe këtë vit akademik gjinia mashkullore dominon ndaj asaj femërore (prej profesorëve të brendshëm 25% janë të gjinisë femërore ndërsa 75% të gjinisë mashkullore).

Duhet theksuar se procesi i zgjedhjes dhe rizgjedhjes së kuadrit në Fakultetin e Bujqësisë dhe Bioteknologjisë realizohet në përputhshmëri me kriteret e Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Statutit të Universitetit të Tetovës dhe Rregullores për zgjedhje-rizgjedhje.

Tabela 8. Mësimdhënësit e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Bioteknologjisë gjatë vitit akademik 2021/2022

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE BIOTEKNOLOGJISË							
I rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Ordinar	2	0	2	Ordinar	1	0	1
Inordinar	2	0	2	Inordinar	0	0	0
Docent	4	2	6	Docent	0	0	0
Gjithsej	8	2	10	Gjithsej	1	0	1

Tabela 9. Asistentët e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Bioteknologjisë gjatë vitit akademik 2021/2022

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE BIOTEKNOLOGJISË							
I rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Asistentë	0	0	0	Asistentë	0	1	1

Mosha dhe gjinia e stafit akademik

Mosha mesatare e stafit është 48,2 vjet. Stafi mësimdhënës përbëhet nga mosha e mesme, ku vlen të theksohet që grup-mosha 30-34, grup-mosha 55-59 dhe grup-mosha 60-64 vjeç janë të përfaqësuar me 25%. Grup-moshat tjera janë paraqitur qartë në tabelën 10.

Tabela 10. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët në FBB sipas gjinisë dhe moshës gjatë vitit akademik 2021/2022

Mosha		Gjinia			Mësimdhënës (docent, inordinar, ordinar)			Bashkëpunëtorë		
		M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej
1	Deri 25	/	1	1	/	/	/	/	1	1
2	25-29	/	/	/	/	/	/	/	/	/
3	30-34	/	/	/	/	/	/	/	/	/
4	35-39	1	2	3	1	2	3	/	/	/
5	40-44	1	/	1	1	/	1	/	/	/
6	45-49	1	/	1	1	/	1	/	/	/
7	50-54	/	/	/	/	/	/	/	/	/
8	55-59	3	/	3	3	/	3	/	/	/
9	60-64	3	/	3	2	/	2	/	/	/
10	65 e më shumë	/	/	/	/	/	/	/	/	/
11	Gjithsej	9	3	12	7	2	9	/	1	1

6. STRUKTURA E STUDENTËVE NË STUDIMET DERIDIPLOMIKE

Viti akademik 2019/2020

Promovimi i Fakultetit

Oferta promovuese e Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë bëhet në kuadër të promovimit të përgjithshëm të Universitetit të Tetovës. Ky proces realizohet gjatë muajit prill ku në kuadër të një komisioni prej disa anëtarësh realizohen vizita nëpër të gjitha shkollat e mesme të Maqedonisë së Veriut, por edhe në vendet e rajonit si në Shqipëri dhe Kosovë. Qëllimi i këtyre vizitave është parashtrimi i ofertës akademike dhe të gjitha kushteve cilësore që ofron fakulteti ynë për mbarëvajtjen e studimeve. Përpos tjerash, promovimi i Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë realizohet edhe në kuadër të ditëve të hapura që mbahen në oborrin e Universitetit, me çka ofrohen materiale të ndryshme promovuese. Në vitin akademik 2019/2020 motoja promovuese e të gjitha fakulteteve të Universitetit tonë është “**Përkushtojë së ardhmes**”.

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitin e parë në vitin akademik 2019/2020 në të gjitha programet studimore është 14 (tabela 11). Prej tyre rreth 79% të studentëve të pranuar janë nga Maqedonia e Veriut, kurse 21% të studentëve të pranuar janë shtetas të huaj (nga Republika e Kosovës dhe Shqipërisë). Sipas programeve studimore, nga numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në FBB-Tetovë, rreth 83% janë të regjistruar në programin studimor Prodhimari Bimore, e pastaj vijon programi studimor Agrobiznes me rreth 17%. Përkatësia gjinore e rreth 79 % e studentëve të regjistruar në programet studimore të FBB-së është e gjinisë femërore kurse 21% të gjinisë mashkullore.

Tabela 11. Numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë sipas programeve studimore në vitin akademik 2019/2020

	Programi studimor	Të rregullt		Me Korrespondencë		Gjithsej	Shtetas të huaj		Nacionalitetet		Gjithsej
		M	F	M	F		M	F	M	F	
1	Agrobiznes	2	/	/	/	2	/	/	/	/	/
2	Prodhimtari Bimore	4	1	5	2	12	2	1	/	/	3
3	Prodhimtari Animale	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
	Gjithsej	6	1	5	2	14	2	1	/	/	3

15

**Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë-Факултет за земјоделство и биотехнологија-
Faculty of Agriculture and Biotechnology**

Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk – e-mail: ba@unite.edu.mk

Në tabelën 12 mund të shohim numrin e studentëve sipas viteve të studimit në programet studimore të FBB-së. Numri i studentëve është më i vogël në vitin e tretë, kurse në vitin e dytë, të parë parë dhe të katërt numri i studentëve është më i madh (në vitet 2016/2017; 2017/2018; 2018/2019 ka pasur më shumë studentë të regjistruar).

Tabela 12. Numri i studentëve sipas viteve të studimit gjatë vitit akademik 2019/2020 në **FBB**

	Viti i studimeve	Të rregullt		Me korrespondencë		Gjithsej	Shtetas të huaj		Nacionalitetet		Gjithsej
		M	F	M	F		M	F	M	F	
1	I	6	1	5	2	14	2	1	/	/	3
2	II	4	9	7	/	20	1	/	/	/	1
3	III	8	2	2	/	12	/	/	/	/	/
4	IV	8	1	6	1	16	/	/	/	/	/
	Gjithsej	26	13	20	3	62	3	1	/	/	4

Viti akademik 2020/2021

Promovimi i Fakultetit

Oferta promovuese e Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë që bëhet në kuadër të promovimit të përgjithshëm të Universitetit të Tetovës me moton “**Përkushtoj** së **ardhmes**” nuk ishte e mundur të realizohet gjatë muajit prill për shkak të pandemisë (virusit Covid 19).

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitin akademik 2020/21 në të gjitha programet studimore është 12. 50% e studentëve të pranuar janë nga Maqedonia e Veriut dhe 50% të studentëve të pranuar janë shtetas të huaj (nga Republika e Kosovës dhe Shqipërisë). Sipas programeve studimore, rreth 37% janë të regjistruar në programin studimor Agrobiznes dhe 63% në programin studimor Prodhimtari Bimore. Rreth 37% i studentëve të regjistruar në programet studimore të FBB-së janë të gjinisë femërore kurse 63% të gjinisë mashkullore (tabela 13).

Tabela 13. Numri i studentëve sipas programeve studimore në vitin akademik 2020/2021 në **FBB**

	Programi studimor	Të rregullt		Me korrespondencë		Gjithsej	Shtetas të huaj		Nacionalitetet		Gjithsej
		M	F	M	F		M	F	M	F	
1	Agrobiznes	2	/	1	/	3	/	/	/	/	/
2	Prodhimtari Bimore	/	/	2	3	5	2	2	/	/	4
3	Prodhimtari Animale	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
	Gjithsej	2	/	3	3	8	2	2	/	/	4

Në tabelën 14 mund të shohim numrin e studentëve sipas viteve të studimit në programet studimore të FBB-së. Numri i studentëve është më i vogël në vitin e parë, kurse në vitin e dytë, të tretë dhe të katërt numri i studentëve është më i madh (në vitet 2017/2018; 2018/2019; 2019/2020 ka pasur më shumë studentë të regjistruar).

Tabela 14. Numri i studentëve sipas viteve të studimit gjatë vitit akademik 2020/2021 në **FBB**

	Viti i studimeve	Të rregullt		Me korrespondencë		Gjithsej	Shtetas të huaj		Nacionalitetet		Gjithsej
		M	F	M	F		M	F	M	F	
1	I	2	/	3	3	8	2	2	/	/	4
2	II	6	1	5	1	13	2	/	/	/	2
3	III	8	3	6	/	17	1	/	/	/	1
4	IV	12	2	3	/	17	/	/	/	/	/
	Gjithsej	28	6	17	4	55	5	2	/	/	7

Viti akademik 2021/2022

Promovimi i Fakultetit

Oferta promovuese e Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë bëhet në kuadër të promovimit të përgjithshëm të Universitetit të Tetovës. Ky proces realizohet gjatë muajit prill. Për shkak të pandemisë (virusit Covid 19) nga një komision i zgjedhur prej disa anëtarësh në kuadër të ditëve të hapura realizohet promovimi i Fakultetit online përmes platformës “Google Meet” për të gjithë maturantët e interesuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut, por edhe nga vendet e rajonit, Shqipëri dhe Kosovë. Në vitin akademik 2021/2022

motoja promovuese e të gjitha Fakulteteve të Universitetit tonë ishte “**Përkushtoj** së ardhmes”.

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitin akademik 2021/22 në të gjitha programet studimore është 10. Prej tyre 3 studentë të pranuar janë nga Maqedonia Veriut, kurse 7 studentë të pranuar janë shtetas të huaj (nga Republika e Shqipërisë). Sipas programeve studimore, 8 janë të regjistruar në programin studimor Prodhimtari Bimore dhe 2 në programin studimor Agrobiznes. Përkatësia gjinore e studentëve të regjistruar në programet studimore të FBB-së është 100% e gjinisë mashkullore (tabela 15).

Tabela 15. Numri i studentëve sipas programeve studimore në vitin akademik 2021/2022 në **FBB**

	Programi studimor	Të rregullt		Me korrespondencë		Gjithsej	Shtetas të huaj		Nacionalitetet		Gjithsej
		M	F	M	F		M	F	M	F	
1	Agrobiznes	1	/	1	/	2	1	/	/	/	1
2	Prodhimtari Bimore	1	/	7	/	8	6	/	/	/	6
3	Prodhimtari Animale	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
	Gjithsej	2	/	8	/	10	7	/	/	/	7

Në tabelën 16 mund të shohim numrin e studentëve sipas viteve të studimit në programet studimore të FBB-së. Numri i studentëve është më i vogël në vitin e dytë (2020/2021), kurse në vitin e parë, të tretë dhe të katërt numri i studentëve është më i madh (gjatë viteve 2018/2019; 2019/2020; 2020/2021 ka pasur më shumë studentë).

Tabela 16. Numri i studentëve sipas viteve të studimit gjatë vitit akademik 2018/2019 në **FBB**

	Viti i studimeve	Të rregullt		Me korrespondencë		Gjithsej	Shtetas të huaj		Nacionalitetet		Gjithsej
		M	F	M	F		M	F	M	F	
1	I	2	/	8	/	10	7	/	/	/	7
2	II	2	/	3	3	8	2	2	/	/	4
3	III	6	1	5	1	13	2	/	/	/	2
4	IV	20	5	9	/	34	1	/	/	/	1
	Gjithsej	30	6	25	4	65	12	2	/	/	14

7. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE

Stafi akedemik dhe strukturat e tjera të Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë në vitet akademike 2019/2020, 2020/2021, 2021/2022 kanë qenë aktivë në publikimin e punimeve shkencore, në pjesëmarrje nëpër konferenca shkencore dhe në projekte të ndryshme të realizuara nga Fakulteti.

Në vazhdim, veprimtarinë shkencore të stafit akademik të FBB-së, do ta paraqesim ndaras sipas viteve akademike:

Viti akademik 2019/2020

Stafi akademik i FBB-së, në vitin akademik 2019/2020 kanë deklaruar gjithsej 38 punime shkencore dhe kanë marrë pjesë me 21 prezentime nëpër konferenca shkencore ndërkombëtare. Nga punimet shkencore të publikuara 39.5% (15 punime) i kanë në revista shkencore ndërkombëtare, 34.2% (13 punime) i kanë në revista me impakt faktor (scopus & web of science) dhe 26.3% (10 punime) i kanë në revista të tjera me impakt faktor.

Duke pasur parasysh se mesatarisht çdo punim shkencor dhe çdo prezentim nëpër konferenca bëhet me nga dy deri tre bashkautorë dhe këto bashkëpunime janë në mes kolegëve të të njëjtit program studimor apo fakultet, atëherë për të marrë një pasqyrë sa më reale, të dhënat e mësipërme i pjesëtojmë me 2.5. Kështu marrim: rreth 15 punime gjithsej, prej të cilëve rreth 6 punime janë në revista shkencore ndërkombëtare, rreth 5 punime në revista me impakt faktor (scopus & web of science) rreth 4 punime janë në revista të tjera si dhe rreth 8 prezantime në konferenca ndërkombëtare.

Viti akademik 2020/2021

Stafi akademik i FBB-së, në vitin akademik 2020/2021 kanë deklaruar gjithsej 34 punime shkencore dhe kanë marrë pjesë me 19 prezentime nëpër konferenca shkencore ndërkombëtare. Nga punimet shkencore të publikuara, 44.12% (15 punime) i kanë në revista shkencore ndërkombëtare, 32.35% (11 punime) i kanë në revista me impakt faktor (scopus & web of science) dhe 23.53% (8 punime) i kanë në revista të tjera me impakt faktor.

Duke pasur parasysh se mesatarisht çdo punim shkencor dhe çdo prezentim nëpër konferenca bëhet me nga dy deri tre bashkautorë dhe këto bashkëpunime janë në mes

kolegëve të të njëjtit program studimor apo fakultet, atëherë për të marrë një pasqyrë sa më reale, të dhënat e mësipërme i pjesëtojmë me 2.5. Kështu marrim: rreth 14 punime gjithsej, prej të cilëve rreth 6 punime janë në revista shkencore ndërkombëtare, rreth 4 punime në revista me impakt faktor (scopus & web of science) dhe rreth 8 punime janë në revista të tjera me impakt faktor si dhe rreth 50 prezantime në konferenca ndërkombëtare.

Viti akademik 2021/2022

Stafi akademik i FBB-së, në vitin akademik 2021/2022 kanë deklaruar një veprimtari më të pasur shkencore edhe atë gjithsej 42 punime shkencore dhe kanë marrë pjesë me 29 prezentime nëpër konferenca shkencore ndërkombëtare. Nga punimet shkencore të publikuara, 28.57% (12 punime) i kanë në revista shkencore ndërkombëtare, 16.67% (7 punime) i kanë në revista me impakt faktor (scopus & web of science) dhe 54.76% (23 punime) i kanë në revista të tjera me impakt faktor.

Duke pasur parasysh se mesatarisht çdo punim shkencor dhe çdo prezantim nëpër konferenca bëhet me nga dy deri tre bashkautorë dhe këto bashkëpunime janë në mes kolegëve të të njëjtit program studimor apo fakultet, atëherë për të marrë një pasqyrë sa më reale, të dhënat e mësipërme i pjesëtojmë me 2.5. Kështu marrim: rreth 17 punime gjithsej, prej të cilëve rreth 5 punime janë në revista shkencore ndërkombëtare, rreth 3 punime në revista me impakt faktor (scopus & web of science) dhe rreth 9 punime janë në revista të tjera me impakt faktor, si dhe rreth 12 prezantime në konferenca ndërkombëtare

8. HAPËSIRAT DHE PAJISJET

Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë procesin mësimor e realizon në këto hapësira:

Tabela 17. Hapësirat e UT-së, në shërbim të Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë

	Hapësira	Numri	m²	Numri i ulëseve
1	Objekte	1		
2	Amfiteatër	1	173	143
3	Klasa	8	470	240
4	Laboratorë	3	120	45

20

5	Zyra të kuadrit	3	124	12
6	Zyra të administrates	2	37	6
7	Zyrat e udhëheqësve	2	38	4
8	Depo	2	80	4

Tabela 18. Pajisjet në shërbim të Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë

	Pajisjet	Për studentë	Për kuadrin	Për administratën	Bibliotekë	Gjithsej
1	Kompjuter	20	11	6	1	38
2	Internet kyçës	4	10	6	1	21
3	LCD projektor				/	10
4	Skener					6
5	Printer					6
6	Fotokopje					6

9. SWOT ANALIZA

I. Anët e fuqishme të FBB-së

- Përputhshmëri e plotë e lëndëve obligative dhe atyre zgjedhore me fushën e progamit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit (në kuadër të programeve studimore të FBB-së, mbi 90% e lëndëve obligative janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e progamit studimor sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, kurse rreth 10% e lëndëve obligative janë pjesërisht në përputhshmëri me këtë klasifikim)
- Staf mësimor të kualifikuar që i përmbush nevojat e fakultetit, (në veçanti staf mësimdhënës).
- Moshë e re e stafit akademik, me theks të veçantë ajo e bashkëpunëtorëve.
- Ekziston një balancë gjinore në stafin akademik, si te profesorët ashtu edhe te bashkëpunëtorët.

- Numër i mjaftueshëm dhe konstant i regjistrimit të studentëve (në vitin akademik 2019/20 janë regjistruar 18 studentë; në vitin akademik 2020/21 janë regjistruar 15 studentë; ndërsa në vitin akademik 2021/22 janë regjistruar 23 studentë).
- Numër i konsiderueshëm i regjistrimit të studentëve me shtetësi të huaj (për tre vitet akademike ky numër ka një mesatare prej 30-35 %).
- Veprimtari hulumtuese mjaft e bujshme e stafit akademik të FBB-së (në vitin akademik 2019/2020, kanë botuar gjithsej 38 punime shkencore prej të cilave 1 punim në revista shkencore ndërkombëtare dhe 25 punime në revista me impakt faktor, ndërsa kanë marrë pjesë me 21 prezentime nëpër konferenca shkencore ndërkombëtare. Në vitin akademik 2020/2021, kanë botuar gjithsej 34 punime shkencore prej të cilave 15 punime në revista shkencore ndërkombëtare dhe 19 punime në revista me impakt faktor, ndërsa kanë marrë pjesë me 19 prezentime nëpër konferenca shkencore ndërkombëtare. Në vitin akademik 2021/2022, kanë botuar gjithsej 19 punime shkencore prej të cilave 42 punime në revista shkencore ndërkombëtare dhe 12 punime në revista me impakt faktor, ndërsa kanë marrë pjesë me 29 prezentime nëpër konferenca shkencore ndërkombëtare).

II. Anët e dobëta të FBB-së

- Hapësirë e pamjaftueshme për realizimin e veprimtarisë mësimore-shkencore (FBB shfrytëzon vetëm dy salla për mësim dhe shfrytëzon laboratorët në koordinim me fakultetet e tjera. Duke pasur parasysh që natyra e studimit e disa lëndëve të programeve studimore është eksperimentale dhe praktike, kjo hapësirë që ka në dispozicion FBB-ja nuk është e mjaftueshme për realizimin e plotë dhe me sukses të procesit mësimor-shkencor.

III. Mundësitë (pozitive) që burimin e kanë jashtë fakultetit por janë mundësi për zhvillim të fakultetit.

- Bashkëpunimi i FBB-së me fakultetet simotra nga vendi dhe jashtë, në kuadër të programeve të ndryshme për shkëmbimin e studentëve.
- Shkuarja e asistentëve tanë për studime master dhe PhD në Universitetet e ndryshme të Evropës, të cilët pastaj njohuritë dhe përvojën e marrë atje i bartin në FBB.
- Zgjerimi i bashkëpunimit me kompanitë e ndryshme në vend për kryerjen e pjesës praktike të studentëve.

IV. Kërcënime – anë negative që burojnë nga jashtë e që kërcënojnë zhvillimin e fakultetit

- Mundësia e zvogëlimit të numrit të studentëve të rinj si pasojë e largimit të të rinjve në vende të ndryshme të Evropës, posaçërisht në Gjermani.

10. KONKLUDIMI

Realizimi i procesit të evaluimit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Bioteknologjisë paraqet një çështje mjaft me peshë, e cila përfshin dy segmente kryesore: zbatimin e dispozitave të Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat obligojnë në realizimin e të njëjtit dhe njohja me gjendjen reale në të cilën zhvillohet procesi mësimor-shkencor. Sigurisht se të dhënat përkatëse do të jenë udhërrëfyes për veprimtarinë tonë në vazhdimësi, për përcaktimin e politikave zhvillimore të FBB-së që në këtë mënyrë mund të arrihen rezultate konkrete në sferën mësimore-shkencore dhe hapat konkretë të cilët duhet të ndërmerren për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përsosjes së veprimtarisë administrative në fakultet. Në bazë të rezultateve të fituara nga procesi i evaluimit propozojmë masat dhe rekomandimet vijuese:

- Për realizimin me sukses të procesit mësimor-shkencor në FBB nevojitet të krijohen kushte laboratorike më të mira për realizimin e ushtrimeve të studentëve, por edhe për veprimtarinë hulumtuese të bashkëpunëtorëve dhe profesorëve
- Lëndët obligative dhe zgjedhore në programet studimore të FBB-së kanë nevojë që gjatë akreditimit të ardhshëm të azhurnohen me qëllim të plotësimit të kërkesave bashkëkohore në lidhje me arritjet në shkencë dhe teknologji, ashtu që t'i përshtaten tregut të punës
- Hapja e konkurseve për themelimin e marrëdhënies së punës me vendim në FBB për bashkëpunëtorët part-time të cilët nuk e kanë të zgjidhur problemin e punësimit, sepse në këtë mënyrë ata do të kontribuonin më shumë në zhvillimin dhe avancimin e procesit mësimor-shkencor

- Duhet një angazhim më i madh i profesorëve dhe bashkëpunëtorëve në inkuadrimin nëpër projekte të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare
- Krijimi i organogramit dhe vendosja e tij në hapësirë frekuentuese të fakultetit.
- Përpiluesit e orareve të ligjëratave dhe provimeve të mbajnë llogari që të vendosen kreditë e sakta për çdo lëndë.
- Vendosja e kutive në hapësirë frekuentuese të fakultetit ku studentët do të kenë mundësi të japin sugjerime, ankesa, lëvdata etj.

Tetovë, 19. 11. 2023

**Komisioni i FBB-së
për Evaluim**

1. Doc. Dr. Hirijete Idrizi - kryetare
2. Prof. Dr. Alirami Saliji - anëtar
3. Prof. Dr. Nesim Seferi - anëtar
4. Arion Ziba - përfaqësues i studentëve
5. Arton Ajdari - anëtar nga Parlamenti Studentor